



# Levizja e lire e personave dhe sherbimeve. E drejta e vendosjes

- Levizja e lire e personave (VII)
- Liria e ofrimit te sherbimeve (VIII)
- E Drejta e Vendosjes (VIII)



# Kuadri normativ i levizjes se lire te personave



- Rregullimi ne TFBE Pjesa III Titullit IV “Levizja e lire e personave, sherbimeve dhe kapitaleve”
  - Nenet 45-62
- Neni 26.2 TFBE mbasi percaktohet tregu i perbashket
  - Tregu i brendshëm përfshin një zonë pa kufij të brendshëm, në të cilën sigurohet lëvizja e lirë e mallrave, **personave**, shërbimeve dhe kapitalit, në përputhje me dispozitat e Traktateve.
- Neni 20.2 ger.a) TFBE qe percakton qytetarine e BE
  - “kanë të drejtën të lëvizin dhe banojnë lirisht brenda territorit të Shteteve Anëtare”
- Neni 21.1 TFBE
  - “Çdo qytetar i Bashkimit ka të drejtën të lëvizë dhe banojë lirisht brenda territorit të Shteteve Anëtare, në varësi të kufizimeve dhe kushteve të përcaktuara nga Traktatet dhe masat e miratuara në zbatim të tyre”
- Liria e qarkullimit te personave nuk lidhet me ngushtesisht me krijimin e tregut te perbashket si qellim i BE
  - Liria e punes
  - Liria e ofrimit te sherbimeve
- Neni 45.1 Karta
- Jurispridenca e GjD e percakton levizjen e lire si nje liri themelore



# Kuadri normativ



- TFBE percakton parime te pergjithshme per aktualizimin e lirise se levizjes
  - Nenet 45-48 ne lidhje me levizjen e punetoreve
  - Nenet 49-55 me te drejten e vendosjes
  - Nenet 56-62 ne lidhje me ofrimin e sherbimeve
- Ndalimi i diskriminimit
  - Neni 18 ndalon diskriminimin mbi baza kombesie per qytetaret
  - Neni 45.2 per punetoret
  - Neni 49.2 per te drejten e vendosjes
  - Neni 57.2 per sherbimet
- Mundesia e vendosjes se
  - Perjashtimeve nga liria e levizjes
  - Kufizimeve
- Normat e TFBE jane me efekt direkt ne kete fushe
  - Per lirine e vendosjes shiko Ceshtja 2/74 Reyners ku GjD shprehet se megjithese programatike njehere qe nuk eshte implementuar neni 49 eshte nje norme qe mund te kerkohet drejteperdrejte nga qytetaret e Shteteve antare (pikat 24-27)
  - Per nenin 45 shiko Ceshtja 41/74 Van Duyn pika 6



# Kuadri normativ II



- Normat e TFBE duhet te interpretohen duke respektuar Te Drejatat Themelore te njeriut
  - Shiko C-60/00 Carpenter per nje analize te GjD
    - Pikat 32 dhe 44
- Normat e TFBE jane dhe baza ligjore per te nxjerre akte te se drejtes dytesore per te rregulluar lirine e levizjes se personave
  - Neni 18.2 dhe 21.1 e 2. per qytetaret
  - Neni 46 dhe 48 per punetoret
  - Neni 50, 51.2, 52.3 dhe 53 per te drejten e vendosjes dhe sherbimet
- Prodhimi legjislativ i meparshem ishte i ndryshem per lirite e levizjes se ndryshme
  - Psh Rreg. KEE 1612/68 per lirine e levizjes se punetoreve etj
  - Aktualisht Dir. 2004/38/KE
    - Flet per qytetare BE dhe jo punetore, punetore autonome apo student
    - Kodifikon te gjithe prodhimin legjislativ te mepershem dhe jurisprudence e GjD
    - Bazohet te normat 18, 21, 4, 51 dhe 59 TFBE
- Mbas hyrjes ne fuqi te qytetarise europiane
  - Legjislacioni behet duke patur parasysh cdo qytetari dhe jo kategorive te vecanta



# Kuadri normativ III



- Me rendesi te vecante aktet ligjore te nxjerra nga BE ne fushen e sigurimeve shoqerore sipas nenit 48 TFBE
  - E drejta per te bashkuar periudhat kontributive – liria e qarkullimit e sigurimeve shoqerore
  - Neni 48 TFBE percakton se ne Keshill nje shtet mund te vendose veto
    - Pezullohet procedura e zakonshme
  - Rreg. KE 883/2004 Mbi koordinimin e sistemeve te sigurimeve shoqerore
    - Parimi i trajtimit kombetar
- Liria e levizjes dhe Brexit
  - Humbje e te drejtes per te qarkulluar dhe qendruar lirisht
  - Marreveshja mbi daljen percakton periudhe tranzitore
  - Me marreveshje ato qe e kane aktualisht vendodhjen ne vendet respective e mbajne kete te drejte edhe pas periudhes tranzitore
  - Neni 50, 51.2, 52.3 dhe 53 per te drejten e vendosjes dhe sherbimet



# Subjektet perfituese



- Qytetaret e BE (neni 20 dhe 21 TFBE)
  - Ne analizen e GjD ne C-413/99 Baumbast pika 81-83
- E drejta per levizur lirisht
  - Punetoret/Punemarresit
  - Punetoret autonome – qe ofrojne sherbime
    - Sipas GjD edhe ato qe i marrin sherbimet
      - Ceshtjet 286/82 dhe 26/83 Luisi
      - C-169/08 Keshilli Ministrave Italian
    - Vazhdon perdoret edhe pas qytetarise pasi ka interes
      - Sidomos ne lidhje me te drejten per qendrim dhe jo vetem me qarkullimin e lire
  - Qytetaret
  - Familjaret e tyre
- Punetoret/Punemarresit
  - Llogjika fillestare ishte ne funksion te tregut te perbashket BE – objektiv ekonomik
  - Ne nje moment te dyte llogjika e puntorit ne dimensionin njerezor



# Subjektet perfituese II - Punemarresit

- Punemarresit
  - Nocioni juridik jo domosdoshmerisht i njejte me nocionin e vendeve antare BE
    - Ceshtja 75/63 Unger
  - Ceshtja 66/85 Lawrie/Blum pika 17
    - Lidhje nenpunesie
    - Kohezgatje
    - Kunderpagese shperblim per punen
  - Perfshihet edhe ish-punetori
    - Nuk e humb cilesimin si punemarres edhe pse nderpritet marredheniet e punes
  - Perfshihet dhe punekerkuesi i papune
    - GjD ka percatur se e ka te drejten te levize per te kerkuar pune dhe nuk kanevoje per nje ftese pune efektive
    - C-292/89 Antonissen pika 13
- Punetori autonom
  - Liria e ofrimit te sherbimeve
- Familjaret e punemarresve
  - Te drejta qe derivojne nga e drejta e punemarresit (edhe nese jane nga Shtete te treta)
    - Mbas lindjes si e drejte mbetet autonome pa patur nevoje te tregohet lidhja me punemarresin
  - Neni 2.2. Dir. 2004/38/KE perfshihet bashkeshorti/ja, partneri ne bashkimet e regjistruara, femijet dhe personat ne ngarkim nen 21 vjec, paraardhesit ne ngarkim
    - Koncepti i bashkeshortit (GjD shprehet C-673/16 Coman pika 24, 34-35 dhe 48-50)



# Subjektet perfituese III

- Kushti i transnacionalitetit
  - Nuk merren parasysh situatat e brendshme brend anje Shteti antar
    - Jurisprudence e gjere e GjD
  - Per jurisprudencen mundet qe liria e levizjes mund te kerkohet edhe ndaj Shtetit kombetar te tij nga qytetari i BE
    - Ne rastet kur ai po pergatitet apo eshte gati per nje ekperience pune ne nje Shtet tjetet antar apo vjen nga nje Shtet antar drejt shtetit te tij kombetar
    - Ceshtja 115/78 Knoors pika 14
    - C-415/93 Bosman





# Subjektet perfituese III



- Kushti i transnacionalitetit
  - Nuk merren parasysh situatat e brendshme te nje Shteti antar
    - Jurisprudence e gjere e GjD (shiko C-434/09 McCarthy pika 39 dhe 42)
  - Per jurisprudencen mundet qe liria e levizjes mund te kerkohet edhe ndaj Shtetit kombetar te tij nga qytetari i BE
    - Ne rastet kur ai po pergatitet apo eshte gati per nje ekperience pune ne nje Shtet tjetet antar apo vjen nga nje Shtet antar drejt shtetit te tij kombetar
    - Ceshtja 115/78 Knoors pika 14
    - C-415/93 Bosman
- Liria e levizjes se personave
  - E drejta per te dale dhe per tu kthyer ne shtetin kombetar
  - E drejta per te qendruar ne shtetet e tjera antare
  - E drejta per te punuar ne shtetet e tjera antare si punemarres apo autonom
  - E drejta epr te kerkuar pune ne shtetet e tjera antare
  - E drejta e bashkimit familjar
  - E drejta e qendrimit te familjareve
  - E drejta e trajtimit te barabarte per vete dhe familjaret
  - Edrejta e e aksesit ne sistemin arsimor dhe formimin profesional
  - E drejta e qendrimit



# E Drejta e Qendrimit I



- Tre tipologji të së Drejtes së qendrimin (Dir. 2004/38/KE)
  - Qendrimi deri në 3 muaj (neni 6)
    - Të gjithë qytetarëve të BE dhe familjarëve të tyre nga vendet e tregut
    - Kufizohet nga disponimi i resurseve ekonomike apo mosberjbarre të sistemit të asistencës sociale (neni 14)
  - Qendrimi për më shumë se 3 muaj (neni 7)
    - Punëtorët apo punëtorët autonomë në shtetin pritës
      - Pa kushte
      - Edhe punëkërkuarit por me kushte sipas nenit 14.4 pikat b) (shiko C-710/19 G.M.A. pikat 25-27, 42, 44, 46-47)
    - Studentët
      - Kushti i pasjes së një sigurancë shëndetësor
      - Kushti i pasjes së mjeteve ekonomike të mjaftueshme
    - Qytetarët
      - Kushti i pasjes së një sigurancë shëndetësor
      - Kushti i pasjes së mjeteve ekonomike të mjaftueshme (ndryshe nga studentët ky duhet të provojë që i ka efektivisht)
    - Familjarët që shoqërojnë kategoritë e mesipërme dhe pse qytetarë të vendeve të treta
      - Nuk humbet e drejta edhe në rast divorci apo anulimi martesë nëse kanë zgjidhur të paktën 3 vite
      - Kushti i pasjes së mjeteve ekonomike të mjaftueshme (ndryshe nga studentët ky duhet të provojë që i ka efektivisht)
  - Qendrimi i përhershëm (neni 16)
    - Kushtet
      - Qendrim i ligjshëm
        - » C-424/10 dhe C-425/10 Ziolkowski dhe Szeja (pikat 46 e 47)
      - Në mënyrë të vazhduar
        - » C-162/09 Lassal
      - Për 5 vite
        - » C-378/12 Onuekwere pikat 24-26 dhe 28
    - Jo me kushtet e qendrimin për më shumë se 3 muaj (janë implicite shiko më lart)
    - I takon dhe familjarëve nga shtetet e treta nëse kanë kushtet e mesipërme
      - Interpretim i gjere i jetes bashkeshortore C-244/13 Ogieriakhi pikat 37/40
    - Humbet në rast mosbanimi për dy vjet të vazhdueshme
    - Nuk mund të kërkojë perkundrejt shtetit të kombesise



# E Drejta e Qendrimin II



- Nuk mund të kërkojë perkundrejt shtetit të origjinës (Dir. 2004/38/KE)
  - Neni 3 par 1
  - Interpretim nga GjD shiko C-434/09 McCarthy pika 39 dhe 42)
  - GjD përcakton se mund ta kërkojë të drejtën e qëndrimit direkt në bazë të së drejtës primare në kuadër të lirisë së lëvizjes
    - E drejta e qytetarit që ka një aktivitet në Shtetin e tij dhe që lëviz rregullisht Brenda Bashkimit të këtyre me vetë bashkeshortin i cili është nga një shtet i tjetër
      - C-60/00 Carpenter pika 38 dhe 39
      - C-457/12 S.G. pika 40
    - E drejta e qytetarit për të rikthyer në shtetin e tij të origjinës bashkë me familjarët e tij të një shteti të tjetër pasi ka kryer një periudhë qëndrimi në një vend të BE
      - Migrimi qarkullues
      - Të ruhet uniteti i familjes
      - C-127/08 Metock
      - C-370/90 Singh; C-291-05 Eind ; C-673/16 Coman
  - Kushtet për të kërkuar të drejtën e qëndrimit dhe në shtetin e origjinës të njëjta si në Direktivën 2004/38/KE
    - C-456/12 O.B. pika 50 dhe 52
  - E drejta për të vazhduar në shtetin origjinës të jetes familjare të krijuar në një shtet tjetër antar të BE
    - C-673/16 Coman



# Trajtimi i barabarte



- Ndalimi i diskriminimit mbi baza kombesie per lirine e levizjes
  - Neni 18 par 1 TFBE
  - Me afermimin e qytetarise europiane ka marre vlere te shtuar ky parim
    - C-184/99 Grzelczyk pika 31
    - C-384/08 Attanasio
  - Ne te drejten primare normativat e vecanta perdorem me shume nga GjD
    - Neni 45.2 per punemarresit
      - C-512/13 Sopora pika 25
    - Neni 49.2 per lirine e vendosjes
    - Neni 57.2 per ofrimin e sherbimeve
- Parimi i trajtimit kombetar
  - I percaktuar ne te drejten primare
  - I shtjelluar ne te drejten e derivuar si psh Dir. 2004/38/KE neni 24.1
    - C-333/13 Dano pika 61
- Diskriminimi
  - Direkt – kur normat kombetare i rezervojne disa te drejta qytetareve te tyre dhe perjashtojne qytetaret e shteteve te tjera antare apo i vendosin ketyre kushte shtese (klausolat e kombesise)
    - Ndalohet per punetoret (neni 45.2)



# Trajtimi i barabarte II – Diskriminimi direkt

- Diskriminimi direkt mbi baza kombesie qe mund te marre mbrojtje
  - Neni 45 par 2 TFBE
    - “ndalimin e çdo diskriminimi për shkak të shtetësisë mes punonjësve të Shteteve Anëtare, sa i takon punësimit, shpërblimit dhe kushteve të tjera të punës dhe marrëdhënieve të punës.”
  - Rregullore BE 492/2011
    - Rreg. 1612/68 (abroguar)
    - Garantohej trajtimi kombëtar për aksesin në tregun e punës (nenet 1-6) dhe punën (nenet 7-9)
    - Garantohej trajtimi kombëtar edhe për familjarët e punëtorit
  - Pozicioni i GjD
    - Ka aplikuar në mënyrë shumë të gjere ceshtjen e garancive të mosdiskriminimit për arsye kombesie për ceshtje sociale (Ceshtja 207/78 Even) apo ndihma e papunesise (Ceshtja 261/83 Castelli), rroga minimale (Ceshtja 32-75 Cristini) etj
  - Edhe kur diskriminimi vjen nga kontratat kolektive apo individuale te punes (neni 7.4)
    - Ceshtja 36/74 Walrave
- Edhe për të drejtën e vendosjes
  - Neni 49.2 TFBE
- Edhe për lirinë e ofrimit të shërbimeve
  - Neni 57.3 TFBE
- Edhe për qytetaret e thjeshtë BE
  - Neni 18.1
  - Shiko C-184/99 Grzelczyk pika 46 – E drejta për të përfituar një kontributin minimax
  - C-85/96 Martinez Sala; C-274/96 Bickel; C-22/18 Topfit dhe Biffi



# Trajtimi i barabarte III – Diskriminimi indirekt

- Diskriminimi indirekt mbi baza kombesie
  - Nga norma qe vendosin kushte qe i aplikon te gjithëve (edhe qytetareve te tyre kombetare), pa perjashtim kombesie, por qe jane te permbusheshme me me veshtiresi nga qytetaret e shteteve te tjera antare
  - Aplikim ne frymen e traktateve nga ana e GjD
  - Per here te pare ne Ceshtjen 152/73 Sotgiu
    - Mbi te drejten e kompensimit per ndarje qe i takonte punetoreve qe vinin nga nje vend i brendshem i Gjermanise
    - Diskriminonte sepse kryesisht punetoret qe vinin nga jashte Gjermanise ishin me vendbanim ardhje nga jashte Gjermanise
      - Sot ne nenin 3 rreg. 492/2011 "edhe pse te aplikueshme pa dallim kombesie kane si qellim apo si efekt kryesor te perjashtojne qytetaret e shteteve te tjera antare nga puna qe i ofrohet"
- Jurisprudenca e GjD e ka aplikuar ne menyre te gjere konceptin e diskriminimit indirekt mbi baza kombesie
  - Rastet e e residences ne territorin kombetar apo rajonal
    - C-73/08 Bressol
    - C-103/08 Gottwald
    - C-138/02 Collins
    - C-224/Bidar
    - C-155/09 Kom vs. Greqi
  - Rastet e normave qe parashikojne trajtime te ndryshme ne varesi te llojit te aktivitetit qe kryhet kur aktiviteteteve kryhen kryesisht nga qytetare te shteteve te tjera i rezervohet nje trajtim me pak i favorshem
    - C-259/91, C-331/91 dhe C-332/91 Allue – ne lidhje me kontratat e lektoreve ne universitete te gjuheve te huaja qe punesoheshin me kontrata njevjecare



# Trajtimi i barabarte III – Diskriminimi i qytetareve ne dalje

- Diskriminimet e qytetareve ne dalje
  - Kryesisht analizohet ne lidhje me nenin 18.1 TFBE por dhe me nenin 45.2; nenin 56; neni 57
  - Per qytetaret qe e ushtrojne lirine levizjes dhe vetem per kete fakt nga Shteti i tyre kombetar marrin nje trajtim me pak te favorshem se ato qytetare qe nuk e ushtrojne kete te drejte
    - GjD ne C-192/05 Tas Hagen pika 30
    - Holanda vendoste kushtin e rezidences per perfitimin e pensionit per viktimat e luftes
    - Tas Hagen ne momentin e kerkeses ishte transferuar me residence ne Spanje
    - GjD percakton se norma holandeze mund te shkurajoje qytetare te tjere ne kushte analoge qe kerkojne te perfitojne nga liria e levizjes dhe e qendrimit brenda BE (pika 32)
    - Raste C-499/06 Nerkowska; C-221/07 Zablocka-Weyhermuller; C-224/02 Pusa; C-520/04 Turpeinen; C-406/04 De Cuyper; C-152/05 Commissione vs. Gjermani
  - Konsiderohet jo si diskriminim indirekt ne baza kombesie por diskriminon direkt qytetaret ne dalje perkundrejt atyre qe mbajne rezidencen ne territorin kombetar
- Rastet
  - Vendosja e Kushteve per rezidencen ne territorin kombetar
    - Per te perfituar pension apo ndihma ekonomike nga shteti i origjines
  - Ne lidhje me vendin e zhvillimit te aktivitetit apo ofrimit te sherbimit
    - C-109/04 Kranemann – mosdhenia e pageses per personin qe kerkon te kryeje praktike profesionale ne nje vend tjeter nga ai i origjines
    - C-11/06 dhe C-12/06 Morgan
    - C-281-06 Jundt

# Trajtimi i barabarte IV – Diskriminimet e lejuara I

- Diskriminimet e lejuara
  - Nje diskriminim mund te jete i lejuar dhe jo i ndaluar nese (2 Kushte):
    - Te bazohet ne kushte objektive (pavaresisht kriterit te kombesise, moshes, etj)
    - Te respektohet parimi i proporcionalitetit
- Rastet
  - Diskriminimet indirekte ne baze kombesie
  - Diskriminimet direkte ne baze kombesie
    - Nuk lejohen pasi nuk permbushet kushti i objektivitetit
    - Raste te rralla te parashikuara nga GjD
      - C-123/08 Wolzenburg
      - C-182/15 Petruhin ku gjykata shprehet se megjithese kemi te bejme me nje trajtim jo te barabarte ne baza kombesie por i justifikuar per te arritur qellimin e nenit 3.2 TBE per te mos lene pa ndeshkim personat qe kane kryer nje krim (pika 32, 36-37) ne lidhje me ekstradimin e nje qytetari te nje shteti antar drejt Rusise
      - Kryesisht ne fushen e bashkepunimit gjyqesor penal europian apo nderkombetar
  - Diskriminimi ne nje kusht jo direkt diskriminues por qe disavantazhon qytetaret e shteteve te tjera antare (psh kushti i rezidences ne territorin kombetar) mund te justifikohet nese bazohet
    - Kushte objektive te pavarura nga nenshtetesia
    - Dhe proporcionale
    - C-103/08 Gottwald pika 32
  - Diskriminime direkte ndaj qytetareve ne dalje
    - Veshtiresi te provohet kushti i proporcionalitetit



# Trajtimi i barabarte IV – Diskriminimet e lejuara II

- Disa nga diskriminimet e lejuara me vendimet e GjD tani jane ngritur ne nivel legjislativ
- Parashikuar ne Direktiven 2004/38/KE
  - Konsiderohen si Perjashtime nga parimi i trajtimit te barabarte (sidomos ne lidhje me asistencen sociale )
  - Neni 24 par. 2 i Dir. 2004/38/KE
    - Puneckerkuesit
    - Studentet
    - Qytetaret jo ekonomikisht aktive
  - GjD dhe vendimet e dhena per puneckerkuesit
    - Ceshtja 316/85 Lebon pika 25-27 – Trajtimi i barabarte ne fushen e lehtesirave sociale dhe fiskale i referohet vetem punetoreve qe kane nje pune
    - C-138/02 Collins pika 69 dhe 72 – Duke u nisur nga futja e konceptit te qytetarise europiane kerkohet qe Shteti antar nuk mund ta perjashtoje apriori te drejten per asistence sociale dhe se duhet te merret rast pas rasti vendimi nese qytetari i nje shteti tjetër eshte aktivisht duke kerkuar per pune
      - Pak me kunder Dir 2004/38/Ke neni 24.2 me qellim qe lira e levizjes mos kthehet ne nje barre per sistemin e asistences sociale
    - GjD mbas Direktives eshte me e shtrenguar ne gjykimin e rasteve kur puneckerkuesit dhe te papunet mund te kerkojne trajtimin e barabarte dhe mosdiskriminimin
    - **C-67/14 Alimonovic**
      - Personat qe fitojne te drejten e qendrimit sipas Dir 2004/38/Ke jo gjithmone kane edhe trajtimin e barabarte njehere qe ka kaluar kohe (mbi 6 muaj) nga momenti i nderprerjes se marredhenies se punes dhe humbin statusin e punetorit/punemarresit
    - Cfare konsiderohet asistence sociale – sipas direktives neni 24.2 nuk i aplikohet trajtimi i barabarte
      - C-22/08 dhe C-23/08 Vatsouras – dhenia e nje asistence per puneckerkuesit me qellim lehtesimin ne rihzrjen ne tregun e punes nuk eshte asistence sociale dhe bie jashte 24.2 Dir. duke ju aplikuar parimi i trajtimit te barabarte (pika 44, 45 dhe 38)



- Studentet ne Dir. 2004/38/KE neni 24.2
  - Studenti i nje shteti antar qe regjistrohet ne nje shtet tjetër antar ka te drejte te marre burse studimi apo financim per studimet ne rastet kur
    - Ka statusin e punetorit apo punetorit autonomy apo familjar i tyre
    - Ka fituar te drejten e qendrimit te perhershëm sipas nenit 16 Direktives 2004/38/KE
  - C-209/03 Bidar (pikat 57,60 dhe 62)
    - Kerkohej nga an e Britanise rezidenca stable me qellim perfitimin e nje financimi per universitet
    - GjD konstaton se kushti i rezidences se qendrushme eshte diskriminues ne menyre indirekte
    - Duhet gjykuar nese ky diskriminim eshte objektiv dhe proporcional
    - GjD percakton se nuk eshte proporcional ne masen qe nuk njeh si vite residence vitet e kaluara ne nje vend si student
  - GjD riafirmon ne lidhje me studentet parimin e analizes se nje diskriminimi indirket ne kushtet e te qenit objektiv dhe proporcional
    - Per vendime pak me shtrenguese shiko C-158/07 Foster dhe C-233/14 Kom. vs. Holande
- Qytetaret ekonomikisht jo aktive ne Dir. 2004/38/KE neni 24.1
  - Qe nuk jane student apo punekerkues
  - GjD ka percaktuar se ato mund te perjashtohen nga
    - Ndhima sociale C-333/13 Dano
    - Skema e sigurimeve shoqerore jo kontributive per qytetaret kombetare C-308/14 Kom. vs. Britani
  - Duhet permbushur kushti i qendrimit te ligjshem konform Dir. 2004/38/BE
    - C-333/13 Dano pikat 63, 81, 82, 84
- Perjashtimi gjuhesor sipas Rregullores BE 492/2011
  - Mund te mos trajtohen ne menyre te barabarte kur eshte e rendesishme gjuha nisur nga natyra e punes se caktuar
    - Ceshtja 379/87 Groener
    - C-424/97 Haim



# Perjashtimet nga liria e levizjes se personave

- Te parashikuara ne TFBE 2 lloje perjashtimesh kryesore
  - Kufizimet e vendosura ne lidhje me rendin publik, sigurine publike dhe shendetin publik (neni 45.3)
  - Liria e levizjes se personave nuk i aplikohet punes ne administraten publike (neni 45.4)
- Njesoj edhe per lirine e vendosjes (neni 52.1 dhe 52.2) dhe ofrimin e sherbimeve (neni 62)
  - Neni 51.1 shprehet per rastet e ushtrimit te kompetencave publike dhe pse jo vazhdimisht
- Liria e qarkullimit te qytetareve
  - Nuk ka norma perjashtuese dhe i aplikohen te mesipermet nisur nga neni 21.1 qe thote ne pjesen e fundit se gezohet “në varësi të kufizimeve dhe kushteve të përcaktuara nga Traktatet dhe masat e miratuara në zbatim të tyre”, ergo, masat per arsye rendi publik, sigurise publike dhe shendetit publik
- Perjashtimet aplikohen menje interpretim kufizues nga institucionet e cila ka gjetur konfirmim nga GjD
  - C-482 dhe C-481/01 Orfanopulos
    - Koncepti i qytetarisë europiane ka sjelle nevojën e një interpretimi vecanerisht kufizues te perjashtimeve nga liria e levizjes se personave
  - C-66/18 Kom. vs. Hungari (Enseignement Superior)
    - Autoritetet publike duhet te vleresojne mire rast pas rasti dhe ne menyre konkrete dhe te bazuar qe jemi ne kushtet e perjashtimit nga liria e levizjes (pika 180)



# Perjashtimet nga liria e levizjes se personave I

- Perjashtimet per arsye te rendit publik, sigurise publike dhe shendetit publik
  - Aktet zbatuese
    - Dir. 64/221/KEE
    - Sot nenet 27-33 Dir. 2004/38/KE
  - Ky lloj perashtimi nuk mund te kryhet per arsye apo qellime ekonomike (neni 27.1 Dir.)
- Kushtet per lejim te perjashtimeve
  - Parimi i proporcionalitetit
    - C-331/16 dhe C-366/16 K. dhe F. pika 62
    - Ne lidhje me llojin e mases se marre
      - C-348/96 Calfa ne lidhje me jetegjatesine e mases se debimit te marre – sot rreg nga Direktiva 2004/36/KE neni 32
    - Ne lidhje me graden e integritimit te personit ne Shtetin antar
      - Duhet vleresuar rendesia e arsyeve te redinti publik ne balancim me integrimin e personit ne Shtetin antar ne fjale (neni 28 Dir.)
      - C-145/09 Tsakouridis
      - C-316/16 dhe C-424/16 B. dhe Vomero pika 61 71 dhe 72
      - C-482 dhe C-481/01 Orfanopoulos pikat 95, 98 dhe 99
    - Asnje kusht personal i rastit ne shqyrtim nuk eaktivizon automatikisht procedure e perjashtimit nga liria e levizjes per arsye rendi publik dhe sigurie
      - C-331/16 dhe C-336/16 K. F. Pikat 46, 51 dhe 54
  - Te merren duke patur parasysh sjelljen personale te personit ndaj te cilit merret masa
    - Kushtet personale te paraqesin nje rrezik real dhe te rende qe mund te bjere ndesh me nje interes thelbesor te komunitetit
    - Ceshtja 67/74 Bonsignore
    - Ceshtja 30/77 Bouchereau
    - C-33/07 Jipa
    - C-673/16 Coman
  - Ne raport me parimin e mosdiskriminimit
    - Duhet mbajtur parasysh



# Perjashtimet nga liria e levizjes se personave II

- Perjashtimet per arsye te rendit publik, sigurise publike dhe shendetit publik
  - Garancite procedurale ne favor te personit ndaj te cilit merret masa (neni 31 Dir.)
    - Njoftimi i motiveve
    - Mjetet e ankimit
    - Koha minimale prej 1 muaji per tu larguar me deshire
    - Te drejten per akses ne mjetet juridiksionale per kundërshtim
  - Mbetet problem rastet e sigurise kombetare
    - C-300/11 ZZ, pika 57
- Perjashtimet nga liria e levijes per pune ne administraten publike
  - Interpretuar ne menyre kufizuese
    - Ceshtja 149/79 Kom. vs. Belgjike pika 10
      - Percakton vetem ato detyra pune te cilat kanete bejne me interesin e pergjithshem te shtetit apo organizmave publike
    - Jurisprudence e gjere : infermiere, mesues, kerkues shkencore, sektoret e telekomunikacionit, energjise, gazit apo transportit, etj.
  - Ne menyre kufizuese edhe interepetimi ne lidhje me neni 51 ne fushen e te drejtes se vendosjes dhe, sipas nenit 62, edhe ne fushen e ofrimit te sherbimeve
    - Vetem ne rastet kur keto sherbime kerkojne marrjen pjese direkte ne nje ushtrim te kompetencave publike
      - Ceshtja 2/74 Reynes
      - Ceshtja 147.86 Kom. vs. Greqi
    - Jurisprudence ka perjashtuar raste te: avokatise, konsulentet ne aksidente rrugore, koncesionin e lojrave te fatit, ndermarrjet qe ofrojne sherbimet e rojes private, perkthyesve ne gjykata, notereve, etj.
    - Ne sens te kundert ne lidhje me akreditimin e institutive qe kryejne vleresimin e konformitetit te produkteve ne qarkullim
      - C-142/20 Analisi G. Caracciolo pika 37, 48-53
      - Ushtrim i kompetencave ngushtesisht publike dhe nuk lejohet liria e vendosjes



# ***Contacts:***

---

Thank you for your attention!  
Any question ?

**Assoc. Prof. Dr. Av. Arber Gjeta**

Chair JM in EU Law  
Department of Law  
Faculty of Economy  
University of Elbasan  
[arber.gjeta@uniel.edu.al](mailto:arber.gjeta@uniel.edu.al)



With the support of the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union